

KËRKESË
Nr. 4292, datë 19.8.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Pronarët e konfirmuar nga ZVRPP Vlorë, do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është gjithsej 7,464,400 (shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË KULTURËS
Elira Kokona

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m²)		Çmimi lekë/m²		Vlera lekë		SHENIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Njesi	
1	Areti Zaho	1481	28		40.00		32,516	-	1,300,640.00	sipas vërtetimit të pronësisë
2	Thodhori Duni	1481	1	270.000	160.00	3,560	32,516	961,200	5,202,560.00	sipas regjistrit hipotekor
				270.00	200.0	3,560	32,516	961,200	6,503,200	7,464,400
				Totali:	7,464,400					